

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEGA E NOTERISË DURRËS
ZYRA NOTERIALE ELBASAN
Nr. 125 Rep.



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, në datën **06.02.2020 (dymijë e njëzetë)**, para meje noter Fjorel R. ÇOMO, anëtar i Degës së Noterisë Durrës, me seli pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, u paraqit personalisht:

Z. KRISTO ZHAPA, i biri i Thoma-it i datëlindjes 01.07.1985 lindur në Hormovë, Tepelenë dhe banues në Njësia Bashkiake nr. 4, rruga "Qemal Stafa", Pallati 19, Shkalla 1, Ap. 2, Tirana madhorë me zotësi të plotë juridike për të veprar, mbajtës letërnjoftimi nr. **030123853** dhe nr.personal **I50701033P** me vullnet të lirë e të plotë, për identitetin e të cilëve u sigurova në bazë të dokumentave identifikues personal dhe pasi konstatova se i ka të gjitha aftësitë e ligjit, me kërkesën e tij i vërtetova nënshkrimin e tij të mësipërm, në këtë Akt-Themelimi jashtë zyre noteriale të Shoqërisë "ALBSTRUKTUR" sh.p.k. i cili nënshkruajti, duke vënë firmën në fund të çdo faqe, ndërsa në faqen e fundit nënshkruajti duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij në këtë zyrë noteriale, para meje Noterit.

Unë Noteri vërtetoj rregullsinë në bazë të Ligjit 110/2018 "Për Noterinë".

NOTER

FJOREL R. ÇOMO

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Fjorel R. Çomo", is written over the typed name "FJOREL R. ÇOMO".



AKT-THEMELIMI I SHOQËRISË “ALBSTRUKTUR” SH.P.K.

Me cilësinë e 1 (një) ortaku Themelues:

Unë **KRISTO ZHAPA**, i biri i Thoma-it i datëlindjes 01.07.1985 lindur në Hormovë, Tepelenë dhe banues në Njësia Bashkiake nr. 4, rruga “Qemal Stafa”, Pallati 19, Shkalla 1, Ap. 2, Tiranë madhorë me zotësi të plotë juridike për të veprar, me vullnet të lirë e të plotë, në cilësinë e ortakut të vetëm të mbështetur:

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në Ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare, në Ligjin “Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit” në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojë këtë shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin **“ALBSTRUKTUR” sh.p.k.**

KREU I

Themeli, Emri, Personaliteti Juridik Objekti, Kohëzgjatja, Selia, Vula

Neni 1

Data e Themelimi, Emri dhe Themeluesit

Sot më datën 06.02.2020 unë themeluesi kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“ALBSTRUKTUR” sh.p.k.**

Neni 2

Personaliteti Juridik

Shoqëria “ALBSTRUKTUR” sh.p.k. është person juridik i të drejtës tregtare shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur Shoqëria).

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “ALBSTRUKTUR” sh.p.k. është një shoqëri që kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga 1 (një) ortak i vetëm i cili përballonë humbjen deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara.

Neni 3

Objekti

- Projektim i ndërtimeve civile dhe industriale në fushën e ndërtimit të çdo lloji.
- Studim dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtuesave të çdo lloji.
- Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh ndërtimore.
- Vlerësimi i pasurive te paluajtshme.
- Vlerësimi i ndikimit në mjedisë.



- Projektim dhe zbatim i impjanteve të ventilimit, ngrohje dhe ftohje të çdo lloji.
- Punime tëpërgjithshme ndërtimi, si ndërtimë civile dhe industriale të çdo lloji.
- Tregëti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, pajisje elektroshtëpiake, elektronike, material ndërtimi, vegla pune.
- Import, Export.
- Kryerja e çdo lloj punimi tjetër në fushën e ndërtimit që do të përcaktohet në Liçencën përkatëse që do të paiset nga institucionet përkatëse.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Rruga “Shyqyri Bërxolli” Pallati “INTER CO-SAT” Apartament nr. 5A, Kati i 3^{te}, Tiranë, Shqipëri.

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektornik është e-mail: albstruktur@gmail.com.

Neni 6

Vula

Shoqëria ka vulën e saj, në brendësi të së cilës shkruhet i plotë emir i Shoqërisë “SHOQËRIA ALBSTRUKTUR” SH.P.K, TIRANË, SHQIPËRI”.

KREU II

Kaptali

Neni 7

Kaptali Themeltar

Kaptali Themeltar i Shoqërisë është 100 000 (njëqindë mijë) Lekë dhe është i përbërë në 1 (një) kuot me vlerë nominale 100 000 (njëqindë mijë) Lekë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:


1- Ortaku i vetëm themelues **Kristo Zhapa**: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 100 000 (njëqindë mijë) Lekë, 100 % të kapitalit.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme / të paluajtshme ose të drejta).

Neni 8

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.



Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë
- shitblerjes
- trashëgimisë
- dhurimit
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj

KREU III

Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Neni 10

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) ndryshimin e statutit;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjën c dhe d të kësaj pike;
- e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë preqatjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asmablesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara në ligj apo statut;

Ortakët mund të përfqësohen në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asmablesë së përgjithshme e cila përfshinë edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Administrimi

- 1- Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 2- Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktiveve të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 3- Z. Kristo Zhapa me adresë Njësia Bashkiake nr. 4, rruga "Qemal Stafa", Pallati 19, Shkalla 1, Ap. 2, Tiranë, caktohet si Administrator i parë i shoqërisë "ALBSTRUKTUR" sh.p.k.

Neni 12

Kompetencat e Administratorit

Administratori kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset pér mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, sëbashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme pér miratim;
- e) krijonë njësistem paralajmërimi në kohën e duhur pér rr Ethanat, që kërcënojnë mbrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryen regjistrimet dhe dërgonë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin pér Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raporton përparrë asamblesë së përgjithsme në lidhje me zbatimin e politikave dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë pér veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërasë Asamblenë Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivët e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të clat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat financiare të certifikuara;



- shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU IV
Viti Financiar-Eksperetët

Neni 13

Viti Financiar

Viti finaciar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

KREU V
Prishja-Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 14

Prishja dhe Likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me Ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- e) me vendim të gjykatës

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuditorit dhe emri i shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, Brenda 30-ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të cakatuar një likuidues.



Neni 15

Riorganizimi i Shoqërisë, Bashkimi-Ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 16

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodi Civil dhe çfarëdo ligj tjetër specifik i Republikës së Shqipërisë.

Neni 17

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje m zbatimin apo interpretimin e këtij statuti si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mdis Shoqërsë dhe të tretëve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKU I VETËM
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ALBSTRUKTUR" SH.P.K.**

1) KRISTO ZHAPA

